



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.99/1 dt.27.08.2001

**MBI  
KRITERET E PERZGJEDHJES SE QYTETAREVE QE KANE PARAQITUR  
DOKUMENTACIONIN SIPAS LIGJIT NR.8030 DT.15.11.1995, BRENDA NJE  
KATAGORIE QE PERMBAN KY LIGJ**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.27.08.2001 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Mbi kriteret e përzgjedhjes së qytetarëve që kanë paraqitur dokumentacionin për tu trajtuar me kredi sipas Ligjit Nr.8030 dt.15.11.1995, brenda një kategorie që përmban ky ligj”, mbështetur në Ligjin Nr.8030 dt.15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, në V.K.M Nr.250 dt.16.04.1996 “Për procedurat dhe prioritetet”

**V E N D O S I**

1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes së qytetarëve të pastrehë që kanë paraqitur dokumentacionin për tu trajtuar në zbatim të Ligjit Nr.8030 dt.15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, dhe V.K.M Nr.250 dt.16.04.1996 “Për procedurat dhe prioritetet” si më poshtë:
  - a) Qytetarët kanë Vendim Gjyqi të formës së prerë
  - b) Banesa ish pronë private është në rrezik shembje
  - c) Kur ish pronari ka statusin e të përndjekurit politik
  - d) Probleme të mprehta sociale
  - e) Kur qytetari është në moshë të thyer (nuk premtan kohë për zgjidhjen e problemit të tij të strehimit)
  - f) Gjendja shëndetësore e pjestarëve të familjes (raport mjeko ligjor)
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**

